



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Ministri

2484
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 26.03.2015

UDHËZIM

Nr. 7, datë 26.03.2015

PËR

ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2015

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 50 të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 1013, dt. 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, VKM nr. 67, dt. 10.02.2013 “Për krijimin e IZHA”, VKM Nr. 352, dt. 03.04.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit”

UDHËZOJ

- Zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë si më poshtë vijon:
 - Gjuhë e huaj 6 qershor 2015
 - Gjuhë shqipe 11 qershor 2015
 - Matematikë 16 qershor 2015
- Nxënësit e pakicave kombëtare (greke dhe maqedonase) zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë në lëndën **Gjuhë amtare**. Provimi kombëtar i arsimit bazë në lëndën Gjuhë amtare, do të zhvillohet më datën **18 qershor 2015**.
- Testi i gjuhës së huaj hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në **nivelin gjuhësor A2**.
- Lista e gjuhëve të huaja, që do të jepen si provim i detyruar janë: anglisht, italisht, frëngjisht dhe gjermanisht.
- Nxënësit e klasave të IX parapërgatitore për seksionet dy gjuhëshe italiane, gjermane dhe franceze janë të lirë të zgjedhin midis gjuhës së huaj të parë që kanë filluar në klasën III dhe gjuhës së huaj të seksionit përkatës të filluar në klasën VI.

6. Testi i gjuhës së huaj për nxënësit e klasave të IX parapërgatitore për seksionet dygjuhëshe italiane, gjermane dhe franceze të hartohet dhe të korrigjohet në bashkëpunim me mësuesit e huaj dhe shqiptarë të këtyre seksioneve.
7. Provimet kombëtare të arsimit bazë, të fillojnë në orën 10.00 dhe të zgjasin 2 orë e 30 minuta.
8. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në Rregulloren për **“Procesin e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë 2015”**.
9. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, teza për provimin në lëndën gjuhë amtare, përgatitet nga DAR Gjirokastrë. Zyra Arsimore Delvinë dhe Zyra Arsimore Sarandë, tërheqin në DAR Gjirokastrë tezën ditën e provimit.
10. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, teza për provimin në lëndën gjuhë amtare, përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR Korçë.
11. Nxënësit me aftësi të kufizuara zhvillojnë provimet kombëtare në përshtatje me veçoritë e tyre.
12. Për institutin e nxënësve që nuk shikojnë, drejtorja e institutit tërheq testin nga AKP, një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit brail.
13. Nxënësi mbetës në provimet kombëtare të arsimit bazë ka të drejtën e riprovimit në sesionin e dytë.
14. Inspektoriati Shtetëror i Arsimit monitoron procesin e provimeve kombëtare të arsimit bazë dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur në zhvillimin e tyre.
15. Arkivimi i testeve të bëhet pranë DAR/ZA-ve qendra.
16. Sektori i Statistikës i DAR/ ZA-së merr nga QVT-ja dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet e lirimit. Këto të dhëna dërgohen në AKP, ISHA dhe MAS.
17. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit Parauniversitar, Drejtorja e Shërbimeve të Brendshme, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Inspektoriati Shtetëror i Arsimit, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në *"Fletoren Zyrtare"*.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

